



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

00 Numër: 119/2023

Data: 23.08.2023



## Komuna e Istog

Opština Istok

Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

### KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

**Për: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog**

Në bazë të nenit 43 neni 45 dhe neni 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, neni 5 i Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

## T H Ë R R A S

Mbledhjen e 18-të të rregullt të Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës. Mbledhja do të mbahet më: **31.08.2023, e Enjte**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë në ora 10:00.

## R E N D     D I T E:

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të DKA-së për vitin shkollor 2022-2023;
4. Formimi i komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve nëpër shkolla K. Istog;
5. Falja e Borxhit të tatimit në pronë deri në shumën prej 100 €, sipas Ligjit Nr. 08/L-225 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-006 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme ;
6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

### Vërejtje :

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 paragrafi 39.8 të LVL.



Kryesuesi i Kuvendit  
Z. Enver Rugova

**LIGJI NR. 08/L-224****PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-005 PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-005 PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME****Neni 1****Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë progresivitet të shkallës tatimore, lirim tatimor për vendbanimin parësor dhe tokat bujqësore, faljen tatimore për vitin tatimor 2023 dhe rregullat kufizuese për aplikimin e detyrimit tatimor, dhe interesit, përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (në tekstin e mëtejshëm: Ligji Bazik).

**Neni 2**

Riformulohet neni 9 i Ligjit Bazik dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

**Neni 9****Shkalla tatimore progresive**

1. Tatimi në pronën e paluajtshme bazohet në vlerën e vlerësuar të paluajtshmërisë së tatimpaguesit si bazë tatimore në komunën përkatëse.
2. Baza tatimore për tatimpaguesin me prona të paluajtshme brenda një komune përcaktohet si bazë e vetme tatimore sipas vlerës së kombinuar të të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit.
3. Vlera e detyrimit tatimor llogaritet sipas kufijve në vijim:
  - 3.1. Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.10% deri 1%;
  - 3.2. Për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.20% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafi 3.1 të këtij neni;
  - 3.3. Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.30% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1 dhe 3.2 të këtij neni;
  - 3.4. Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.40% deri 1%, plus tatimi nga nën paragrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3 të këtij neni; dhe
  - 3.5. Për vlerën e pronave mbi pesë milionë (5,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.50% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1, 3.2, 3.3 dhe

### 3.4 të këtij neni.

4. Kuvendi i Komunës cakton shkallën e aplikueshme tatimore për çdo kufi tatimor sipas paragrafit 3 të këtij neni, deri me 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit. Shkallët tatimore të përcaktuara nga komuna duhet të kenë trend progresiv.

5. Nëse Kuvendi i Komunës nuk e përcakton me kohë shkallën e tatimit sipas paragrafit 4 të këtij neni, ministria përgjegjëse për financa do të zbatojë shkallën e fundit tatimore të përcaktuar nga Kuvendi i Komunës.

6. Në rast se shkalla tatimore nuk është vendosur më parë, ministria përgjegjëse për financa do të zbatojë shkallën më të ulët tatimore të aplikueshme në përputhje me kufijtë e tatimit progresiv të pronës së paluajtshme përcaktuara në këtë nen."

### Neni 3

1. Pas paragrafit 1, nën-paragrafit 1.7 të nenit 10 të Ligjit Bazik, shtohen dy nën-paragrafë me tekstin si në vijim:

1.8. Për vendbanimin parësor, deri në tridhjetë mijë (30,000) euro e para të pronës së vlerësuar të personit fizik i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit; dhe

1.9. Për tokën bujqësore, deri në pesëdhjetë mijë (50,000) euro e para të pronës së vlerësuar si njësi bujqësore të personit fizik i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor për cilën njësi bujqësore e kërkon lirimin dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit.

2. Fshihen paragrafët 4 dhe 5 të nenit 10 të Ligjit Bazik, dhe vendoset një paragraf i ri me tekstin si në vijim:

4. Lirimet tatimore të përcaktuara me nën-paragrafët 1.8 dhe 1.9, të paragrafit 1 të nenit 10 zbatohen vetëm një herë brenda vitit tatimor për çdo tatimpagues, pavarësisht nga numri i pronësive dhe/ose posedimeve të tatimpaguesit dhe pavarësisht faktit që njësitë mund të ndodhen në komuna të ndryshme.

### Neni 4

Fshihet neni 11 i Ligjit Bazik.

### Neni 5

Pas Kapitulli II të Ligjit bazik, shtohet Kapitulli II/A me tekstin si në vijim:

## KAPITULLI II/A

### FALJA E TATIMIT NË PRONË PËR VITIN TATIMOR 2023

#### Neni 11/A Pranueshmëria

Çdo tatimpagues që është i detyruar të paguajë tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023 kualifikohet për faljen e tatimit të parashikuar me dispozitat e këtij kapitulli.

**Neni 11/B****Shuma e faljes së tatimit në pronë për pronën e paluajtshme**

1. Shuma e faljes së tatimit në pronë për të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë e faturës së tatimit në pronë për vitin 2023, por jo më shumë se njëqind (100) euro në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli.
2. Vendimi për faljen e tatimit në pronë merret nga kuvendi komunal i çdo komune më së largu 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas kufizimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Në rast se tatimpaguesi ka paguar faturën e tatimit në pronë për vitin 2023, shuma e falur i llogaritet si paradhënie për vitet pasuese.

**Neni 11/C****Kufizimi**

Falja tatimore e parashikuar me këtë kapitull zbatohet vetëm për vitin tatimor 2023 dhe nuk do të zbatohet për asnjë vit tjetër tatimor.

**Neni 11/Ç****Administrimi**

1. Zbatimi i këtij kapitulli mbetet përgjegjësi e çdo komune përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës.
2. Ministria përgjegjëse për financa nxjerr vendime që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e këtij kapitulli.

**Neni 6**

Pas paragrafi 1 të nenit 23 të Ligjit Bazik, shtohet paragrafi 1.a. me tekstin si në vijim:

- 1.a. Për vitin tatimor 2024 dhe vitet tatimore pasuese, detyrimi tatimor për personat jo-rezidentë mund të paguhet në një këst të vetëm, më së largu në datën 30 shtator të vitit tatimor përkatës.

**Neni 7**

Pas paragrafit 2 të nenit 25 të Ligjit Bazik, shtohet paragrafi 3 me tekstin si në vijim:

3. Në asnjë rrethanë llogaritja e interesit në tatimin e papaguar nuk do të vazhdojë të llogaritet pasi interesi i akumuluar të ketë arritur shumën e vetë tatimit të papaguar.

**Neni 8**

Pas nenit 30 të Ligjit bazik, shtohet neni 30/A me tekstin si në vijim:

**Neni 30/A****Afati i parashkrimit të detyrimit tatimor**

1. Afati i parashkrimit të përmbarimit të detyrimit tatimor është dhjetë (10) vjeçar, duke filluar nga data e marrjes së vendimit mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara sipas nenit 30 të Ligjit Bazik.
2. Pas skadimit të periudhës dhjetë (10) vjeçare, detyrimi tatimor konsiderohet i parashkruar dhe komuna nuk ka të drejtë të marrë asnjë masë përmbarimore ndaj tatimpaguesit.

3. Parashkrimi nuk zbatohet në rastet kur:

3.1. Tatimpaguesi ka paguar vullnetarisht një pjesë të detyrimit tatimor pas skadimit të periudhës dhjetëvjeçare;

3.2. Tatimpaguesi ka rënë dakord me komunën për një plan pagese ose shlyerje të detyrimit tatimor; dhe

3.3. Për detyrimin tatimor është marrë një vendim gjyqësor.

4. Afati i parashkrimit pezullohet gjatë procedurës ankimore ose gjatë një procesi gjyqësor në lidhje me detyrimin tatimor.

5. Afati i parashkrimit rifillon nga data e vendimit përfundimtar të marrë në ankim ose procedurë gjyqësore.

**Neni 9**

Në kapitullin X të Ligjit Bazik, Dispozita kalimtare dhe përfundimtare, pas nenit 39, shtohet një nen i ri, 39 /A, me tekstin si vijon:

**Neni 39 /A**

**Shkalla tatimore tranzitore**

Për vitin tatimor 2024 për të gjitha kategoritë e pronave të përcaktuara në nenin 9, paragrafin 1 të Ligjit Bazik, Kuvendet Komunale deri më 30 nëntor 2023 mund të përcaktojnë shkallën tatimore të aplikueshme e cila mund të variojë prej 0.1% deri 1%. Në rast se Kuvendet Komunale nuk marrin vendim për përcaktimin e normave tatimore, vlejnë dispozitat e ligjit bazik.

**Neni 10**

**Hyrja në fuqi**

1. Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Neni 2 i këtij ligji fillon të zbatohet për vitin tatimor 2025, dhe obligohet Kuvendi i Komunës që deri më 30 nëntor të vitit 2024 t'i caktojë shkallët tatimore konform nenit 2 të këtij ligji.

**Ligji Nr. 08/L-224**

**27 korrik 2023**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-148/2023, datë 14.08.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu**

**Subject: Njoftim**

Të nderuar/a,

Ju njoftojmë se me datë 16.08.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare dhe ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-225 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-006 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Përmes këtij Ligji, të cilin mund ta gjeni të bashkëngjitur në këtë email, janë krijuar disa detyrime për komuna, por më i rëndësishmi për kohë është falja prej 100 euro. Komuna përmes kuvendit komunal duhet që brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij Ligji të merr vendim rreth faljes dhe shumës së faljes, por jo më shumë se 100 euro. Data e fundit kur mund të merret ky vendim është data 15.09.2023.

Së dyti, komuna duhet të rishikojnë normat tatimore sipas ndryshimeve të reja, ku minimumi ka zbritur nga 0,15% në 0,10%. Nëse komuna vlerëson se duhet t'i ndryshojë normat tatimore, atëherë kuvendi komunal duhet të vendos për normat e reja deri më 30 nëntor të vitit 2023.

Ligji i ri : <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=80424>

Poštovani,

Obaveštavamo Vas da je datuma 16.08.2023 godine objavljen u Službenom listu i Zakonu br. 08/L-225 o izmenama i dopunama Zakona br. 06/L-006 o porezu na nekretnine.

Ovim Zakonom, koji možete pronaći u prilogu ovog mejla, stvoreno je nekoliko obaveza za opštine, ali je najvažnija u ovom pogledu je oproštaj od 100 evra. Opština je dužna da, preko Skupštine opštine, u roku od 30 dana od dana stupanja na snagu ovog zakona, donese odluku o oproštaju i visini, ali ne više od 100 evra. Poslednji datum kada se ova odluka može doneti je 15.09.2023.

Dalje, opština mora da revidira poreske stope u skladu sa novim izmenama, gde je minimum smanjen sa 0,15% na 0,10%. Ako opština smatra da treba da promeni poreske stope, onda se o novim stopama mora izjasniti skupština opštine do 30 novembra 2023 godine.

Ligji i ri : <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=80424>

**Me respekt ,  
Departamenti I Tatimit në Pronë**



**Republika e Kosovës**

Republika Kosova

Republic of Kosovo



**Komuna e Istogut**

Skupstina Opštine

Municipal Istog

|                               |                                                 |
|-------------------------------|-------------------------------------------------|
| <b>Referencë</b>              |                                                 |
| <b>PËR/ZA/TO:</b>             | Kryetarin e Komunës z. ILIR FERATI              |
|                               | Zyrën e Kryetarit, znj Delvina Sylaj            |
| <b>NGA/OD/FROM:</b>           | Drejtori i Drejtorisë së Arsimit Naim Behlulaj  |
| <b>TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:</b> | Raport i punës për periudhën Janar-Dhjetor 2022 |

Raporti vjetor i DKA-së për vitin shkollor 2022/23

Drejtoria Komunale e Arsimit, kryen detyrat dhe obligimet në përputhje me Ligjin për Arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, Ligjin Për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Ligjin për Arsimin dhe aftësimin Profesional nr.02 L-42, Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin e të rriturve nr. 02/L-24, Ligjin për Arsimin Parashkollor nga MASHT, dhe UA të MASHTT-it që përcaktojnë përgjegjësit e Komunës për organizimin e procesit edukativo-arsimor në të gjitha nivelet si dhe aktet tjera komunale.

Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog, bazuar në vendimet dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës ka ndërmarr të gjitha masat që viti shkollor-mësimor 2022/23 të përfundojë sipas normave të përcaktuara në këto vendime dhe udhëzime,

**Viti mësimor, ka filluar me 1 tetor**( shtyrje për shkak të grevës së organizuar nga SBASHK-u),dhe ka përfunduar (sipas vendimit për plotësim dhe ndryshim të kalendarit të vitit shkollor 2022-2023,nga MASHTI):

- -Klasat e 12-ta me 5qershor 2023,
- -klasat e 9-ta ,10-ta dhe 11-ta,me 27 qershor 2023,
- -klasat e parafillores dhe nga 1-8-ta, më 30 qershor 2023.kurse
- **-Institucionet e kopshteve do ta përfundojnë më 31 korrik 2023.**

Organizimi i punës është udhëhequr dhe menaxhuar nga DKA-ja, drejtorët e shkollave dhe stafi profesional, prindër dhe nxënës, përmes organeve udhëheqëse të shkollës në bashkëpunim të vazhdueshëm me akterët tjerë si MASHTI dhe Sektorin e Inspektoratit për Arsim gjithnjë duke respektuar Ligjin e Arsimit parauniversitar si dhe udhëzimet e lartëcekura.

Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve gjatë kësaj periudhe ka vazhduar bazuar në ofertën e MASHI-t, ofertuesve tjerë dhe në të gjitha rastet është menaxhuar mirë nga DKA-ja dhe adresimi ka qenë aspekti profesional i mësimitdhënësve.

Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me drejtorët e shkollave dhe akterët tjerë institucional lokal dhe qendror, ka organizuar dhe monitoruar procesin mësimor, testin e maturës, dhe testin të arritshmërisë .

Këto organizime dhe monitorime janë bërë në bazë të obligimeve që dalin nga politikat qendrore e lokale të bazuara në planet, strategjitë dhe protokollet e aprovuara me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së shkollës në kontest të rritjes së cilësisë në arsim.

Në përfundim të vitin shkollor 2022/23 numri i nxënësve që do të nënshtrohen testeve,në :

- Testin e arritshmërisë është 527 nxënës, kurse
  - Testin e matures 416 nxënës.
  - Në klasën e parë deri në kohën e raportimit janë regjistruar 522 nxënës.
  - Në klasën e 10-të në Gjimnazin Haxhi Zeka të regjistruar Sipas Kriterve deri në kohën e raportimit janë:108 nxënës në dy drejtime,kurse
  - Në SHMT Mithat Frasheri-janë regjistruar 105 nxënës në 5 drejtime.
- 
- **Për regjistrim në shkollat e mesme është edhe afati i dytë 3 ditë i cili fillon me 22 gusht.**

### **Gjashtëmujori i parë 2022/23**

Viti kalendarik 2022 në DKA-Istog shënon arritjen e shumë rezultateve në fushën e arsimit, qoftë të natyrës, menaxhuese, kadrovike, infrastrukture, që ndikojnë në ngritjen e cilësisë në arsim.

Nga këto veçojmë angazhimin e stafit të DKA-së në menaxhimin e situatës së gjithmbarshme për të siguruar kushte më të mira në mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor, plotësimin e vendeve të lira të punës , apo zëvendësime për arsye të ndryshme, organizimin e trajnimeve për mësimitdhënës etj.

- Gjatë këtij viti shkollor nxënësit e shkollave amë në Llukac të Begut dhe në Uçë kanë filluar procesin mësimor në objekte të reja me ç'rast, kushtet për mësim janë shumë më të mira sesa deri me tani.

- Është bërë renovimi i Qerdhës “Pëllumbat e Ardhmërisë” në Rakosh si dhe në paralelet e ndara në Dubravë dhe në Trubohoc.
  - Është siguruar transporti falas për nxënësit që udhëtojnë në distanca mbi 4 km thuajse për të gjitha lokacionet.
  - Janë ndarë 140 bursa për studentë 4 bursa për nxënës, si dhe 1 bursë për studentë që studiojnë në universitete ndërkombtare.
  - Janë hapur dhe menaxhuar me kohë 17 konkurse për pranim të punëtorëve në shkollat tona.
  - Janë punësuar 80 mësimdhënës, 10 edukatore, 8 asistente për fëmijë me nevoja të veçanta si dhe 4 punëtor teknik, gjithsejtë në vitin 2022 në sistemin arsimor në Komunën e Istogut janë pranuar 102 punëtor në vende të lira apo zëvendësime.
  - Qerdhja “Lulet e Jetës” në Vrellë filloi punën në objekt të Ri e cila është furnizuar me inventar të Ri.
  - Janë siguruar uniformat për nxënës, gjegjësisht uniforma është bërë obligative edhe për personelin arsimor konform rregullorës komunale dhe atyre të brendshme shkollore.
  - Ka filluar punimi i palestrës sportive në Gjimnazin “Haxhi Zeka” në Istog.
  - Është bërë intervenim në të gjitha pligonet sportive të shkollave të komunës sonë për të meremetuar dhe eliminuar defektet ekzistuese, në mënyrë që ato të jenë të përshtatshme dhe të sigurta për nxënësit gjatë shfrytëzimit të tyre.
  - Është bërë vendosja e kamerave në të gjitha objektet edukativo-arsimore të komunes sonë
  - Projekte kapitale të realizuara gjatë këtij viti kalendarik kapin shumën 125208 €.
  - Gjithashtu DKA ka mbuluar shpenzimet e transportit për nxënës në relacione të ndryshme në fshatrat e Istogut në vlerë 65300 €
  - E gjithë kjo punë reflektohet apo dokumentohet me numrin e vendime dhe shkresa që kalon shifrën mbi 1000 sish.
- Ka dhe shumë punë të tjera që janë në vazhdimësi e sipër, apo që nuk e pamë të arsyeshme ti cekim në këtë raport të shkurtër.

## **Gjashtëmuji i dytë i vitit shkollor 2022/23**

Drejtoria Komunale e Arsimit ka vazhduar me organizimin i trajnimeve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në mësimdhënie dhe në të nxënë.

Spektori administrativ sipas planifikimit dhe dinamikës së punës për periudhën raportuese ka realizuar e që konsiderohet si me të rëndësishme:

- Pranimi dhe shqyrtimi dhe vendosja me mbi 400 lëndëve të natyrave të ndryshme që e karakterizojnë drejtorin e arsimit.
- Janë lëshuar 10 vendime për pushim të lehonisë
- Janë lëshuar 20 vendimeve për pensionim të stafit arsimor
- Janë lëshuar 80 vendime për pagesë të mbi normës
- Shpalljen e disa konkurseve për pranim të stafit arsimor
- Janë lëshuar 40 kontrata të punës për mësimdhënës dhe punëtor teknik të të gjitha niveleve të cilët janë pranuar sipas procedurave të rregullta ligjore.
- Shpallja e konkursit për ndarjen e bursave Komunale
- Shqyrtimi i kërkesave për qasje në dokumente zyrtare.
- Shqyrtimi i ankesave të drejtuara këtij drejtorati nga natyrat të ndryshme

### **Projektet kapitale**

Drejtoria Komunale e Arsimit ka përgatitur të gjitha dokumentet dhe ka dërguar në zyrë të prokurimit për procedurën e tenderimit këto projekte :

- Shërbime Profesionale për të rritur dhe fëmijë me nevoja të veçanta,
- Dezinfektimi,dezinsektimi dhe Deratizimi i IP,
- Material për mirëmbajtjen e shkollave,
- Furnizimi i institucioneve shkollore dhe IP me lëndë djegëse-dru dhe pelet.
- Blerja,furnizimi dhe montimi i perdeve shiritore në IP “Gëzimi Ynë”,”Shpresa Jonë”dhe shkollat “Tre dëshmorët “ dhe “Fan Noli”,
- Ndërtimi i infrastruktures se jashtme, gropes septike dhe poligonit sportiv ne Sh.fMartinCamaj – Serbobran ,
- “Ndërtimi i një pjese te rrethojes mbi murin e sh.f.m.u “Tre Deshmoret e Shkollës Shqipe “ në Uçë dhe rrethojës ne Shfmu “Ndre Mjeda”në Rakosh“,
- Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme, fasadimi, ndërrimi i dyerve dhe dritarëve në shkollën”Mithat Frashëri” në Gurakoc ,
- Paisje kabineti , kimi, biologji, gjeografi dhe muzikë për shkollë”
- Furnizimi me rekuizita sportive për nevoja të shkollave”
- Instalimi i kamerave në Institucionet arsimore(shkollë dhe kopshte)

- Ndërtimi i infrastruktures se jashtme ne sh.f.”Bajram Curri”-Dubravë
- Ndërtimi i hapsirave të jashtme në shkollat e komunës së Istogut(Bajram Curri-Istog,Trepça-Banjë
- Blerja e ulseve për shkollat e mesme ,
- Blerja e paisjeve për kabinetin e informatikës,
- Ndërtimi i këndit të lojrave në parafilloret e shkollave fillore te Komunes se Istogut ,
- Ofrimi i Sigurimeve aksidental për nxënës të IAPP “MithatFrashëri”-Gurakoc.

Projektet e reja kapitale të cilat kryesisht janë të financuara nga MASHTI- janë:

-Palestra sportive në Gjimnazin “Haxhi Zeka”-në Istog.

-Shtrirja e rrjetit-Digjitalizimi i Gjimnazit “Haxhi Zeka”-në Istog.

Ndërsa projekti i cili është bartë nga viti 2022 në vitin 2023 dhe financuar nga burimet vetanake është “Ndertimi i kulmit “MithatFrashëri’-Gurakoc,është në përfundim e sipër.

Shpenzimi i Buxhetit në Drejtorin Komunal të Arsimit, për periudhën Janar-Qershor 2023,për kategorinë mallra dhe sherbime dhe Komunali,është:

| INSTITUCIONI      | M+SH         | KOM         | KAPITALE | TOTALI       |
|-------------------|--------------|-------------|----------|--------------|
| DKA               | € 60,879.12  |             | € -      | € 60,879.12  |
| ARSIMI PARAFILLOR | € 22,942.94  | € 3,067.18  | € -      | € 26,010.12  |
| ARSIMI FILLOR     | € 29,291.83  | € 13,793.12 | € -      | € 43,084.95  |
| ARSIMI I MESEM    | € 4,421.22   | € 3,963.02  | € -      | € 8,384.24   |
| TOTALI            | € 117,535.11 | € 20,823.32 | € -      | € 138,358.43 |
|                   |              |             |          |              |

Në kuadër të Drejtorisë së Arsimit nga Komisioni i formuar nga Zyra e Kryetarit që së bashku me Expert të jashtëm është kryer faza perfundimtare dhe është aprovuar në kuvendin komunal:

- **Hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Arsimit për periudhën 2022-2026.**

Vlen të ceket se DKA-ja në Istog ka bërë të gjitha përgatitjet ligjore dhe ka shpallur konkursin për vendet e lira të punës për vitin shkollor 2023/24.

Drejtori i DKA-së:

Naim Behlulaj